



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 244/11 Prot

Tiranë më 17.06. 2015

V E N D I M

Nr. 55 Datë 17/06/2015

Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Këshillit të Qarkut Korçë.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", (i ndryshuar); neneve 80-104 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" si dhe Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me inspektimin e zhvilluar në institucionin e Këshillit të Qarkut Korçë,

VËREJ SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, gjatë muajit mars 2015, është vënë në dijeni të faktit se Këshilli i Qarkut Korçë, është përfshirë në proces ristrukturimi, nëpërmjet një informacioni të marrë nga disa punonjës të këtij institucioni, ndaj të cilëve është vendosur fillimisht pezullimi e më pas, lirimi nga shërbimi civil, për shkak të shkurtimeve të pozicionit të punës.

Duke e konsideruar aktin administrativ të lirimit të tyre nga shërbimi civil, për shkak të ristrukturimit të institucionit, si të kryer në kundërshtim me procedurën e parashikuar në nenin 50 e vijues të ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", (i ndryshuar), si dhe duke pasur parasysh kompetencat e Komisionerit, si institucioni që mbikëqyr administrimin e shërbimit civil, këta punonjës, kanë informuar pranë këtij institucioni në lidhje me pretendimet e tyre, për parregullsi gjatë administrimit të këtij procesi.

Në këto rrethana, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, duke vlerësuar nevojën për verifikim të këtij informacioni, me aktin administrativ nr. 21, datë 11.03.2015, "*Për kryerjen e inspektimit në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, si dhe në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshillit të Qarkut Korçë*", ka vendosur kryerjen e inspektimit të përgjithshëm, duke përfshirë në objektin e

inspektimit, procesin e ristrukturimit, si dhe duke e zgjeruar më tej inspektimin, në të gjitha institutet e tjeta të ligjit për nëpunësin civil.

Sipas vendimit të Komisionerit, inspektimi ishte planifikuar për të filluar në datën 17.03.2015 dhe afati i përfundimit ishte përcaktuar data 10.04.2015, sipas programit të inspektimit dhe njoftimit të dërguar në subjekt, me shkresën nr. 244/1 prot., datë 11.03.2015 "*Njoftim për fillimin e inspektimit në institucionin, Këshilli i Qarkut Korçë*".

Ndërkohë, rezulton se me shkresën nr. 482 prot. datë 25.03.2015, nga ana e titullarit të institucionit të inspektuar, i është kërkuar Komisionerit, shtyrja e afatit të fillimit të inspektimit, me pretendimin se, në datën 25. 03.2015 është miratuar struktura e re e Këshillit të Qarkut Korçë. Nisur nga ky fakt, në zbatim të nenit 54, gërma "d", të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*", vendimi i Këshillit të Qarkut për miratimin e strukturës, kërkon një kohë të caktuar që ka lidhje me konfirmimin e bazueshmërisë ligjore nga ana e Prefektit të Qarkut Korçë, për të filluar efektet juridike.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke e vlerësuar kërkesën e institucionit si të bazuar, me Vendimin nr. 32, datë 03.04.2015, ka miratuar shtyrjen e afatit të inspektimit në Këshillin e Qarkut Korçë, me një afat të arsyeshëm, deri në datën 10.04.2015.

Me përfundimin e këtij afati, grupi i inspektimit, i përbërë nga inspektorët Alda Xhaxhiu dhe Ledina Zhupa, ka vijuar procesin nëpërmjet komunikimit me institucionin, përmes të gjitha rrugëve ligjore, si me postë, komunikim elektronik dhe vizitave në subjekt dhe pasi grumbulloi të dhënat dhe materialet e nevojshme, inspektimi kaloi në fazën e përpunimit të tyre. Më tej është hartuar projektraporti, i cili me shkresën nr.244/8, datë 01.06.2015 "*Dërgohet projekt raporti*", është dërguar për njohje në subjektin e inspektuar, duke i lënë 10 ditë afat për të mundësuar të drejtën e vërejtjeve dhe observacioneve në lidhje me parregullsitë e konstatuara në material.

Pas përfundimit të kësaj faze, me shkresën nr. 244/9, datë 08.06.2015 "*Kthim përgjigje*", projekt raporti është kthyer nga institucioni i inspektuar pa vërejtje, pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i nënshkruar nga titullari i institucionit dhe nëpunësi përgjegjës për administrimin e burimeve njerëzore dhe pas kësaj është përgatitur raporti përfundimtar i inspektimit.

Sa më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, çmon se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova përmbajtjen e raportit përfundimtar të inspektimit, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, si dhe Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

VENDOSA:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Këshillit të Qarkut Korçë, që do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Njësia përgjegjëse, gjatë përgatitjes së strukturës pasardhëse të institucionit, duhet të respektojë disa kërkesa specifike të vendosura me ligje të veçanta, që ndëveprojnë gjatë funksionimit të institucionit, të tilla si ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin, që kërkon një raport të caktuar midis nëpunësit autorizues dhe nëpunësit zbatues, ligje që rregullojnë funksione të deleguara në pushtetin vendor nga administrata shtetërore, të cilat në dispozita të veçanta të tyre, përcaktojnë edhe mënyrën e organizimit të njësive të tilla, si seksionet e administrimit dhe mbrojtjes së tokës apo Inspektoriatet.
3. Njësia përgjegjëse të vijojë procesin e deklarimit të statusit të punësimit dhe më tej, të konfirmojë pozicionin e tyre në raport me sistemin e shërbimit civil, sipas rekomandimeve në raport, duke nxjerrë aktet përkatëse për punonjësit ***** , në pozicionin e punës “Drejtor Urbanistike”; ***** , në pozicionin e punës “Përgjegjes në Drejtorinë e Urbanistikës”; ***** , në pozicionin e punës “Specialist i nivelit të lartë në Drejtorinë e Projekteve Komunitare; ***** , në pozicionin e punës “Kryeinspektor i Inspektoriatit të Ndërtimit”; ***** , në pozicionin e punës Inspektor i nivelit të lartë në INU dhe ***** , në pozicionin e punës Specialist në Drejtorinë Juridike dhe Personelit.
4. Njësia përgjegjëse të evidentojë në strukturën analitike dhe më tej të vijojë procesin e verifikimit të statusit të punësimit për punonjësit e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, në mbështetje të kërkesave të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke konfirmuar pozicionin e tyre në raport me sistemin e shërbimit civil nëpërmjet akteve përkatëse.
5. Të rregullohet ligjshmëria e veprimeve të kryera gjatë procesit të implementimit të strukturës së re të institucionit, nëpërmjet revokimit të akteve administrative që kanë dalë deri në këtë moment dhe që kanë lidhje me pezullimin, emërimin dhe lirimin e nëpunësve të institucionit, që janë pjesë e shërbimit civil, sipas rekomandimeve të dhëna në raportin e inspektimit, në lidhje me procesin e ristrukturimit. Të fillojë procesi nga e para dhe të vijojë duke ndjekur këtë rend pune:

a) Të ngrihet Komisioni i Ristrukturimit, duke u kujdesur që të respektohen kërkesat ligjore në përbërjen e tij, i cili është një mekanizëm që do të propozojë sistemimin dhe trajtimin financiar për të gjithë nëpunësit të cilët do të largohen për shkak të ristrukturimit, duke karahasuar përshkrimin e punës, kërkesat specifike si dhe çdo kërkesë tjetër që rrjedh nga dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë rast, për çdo pozicion që nuk ekziston më. Në këtë rast, duhet të jetë në vëmendjen e njësive përgjegjëse Udhëzimi nr.3, datë 14.04.2014 i Departamentit të Administratës publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”, ku përcaktohen qartë rregullat e përgjithëshme për krijimin dhe funksionimin e këtij mekanizmi.

b) Komisioni i Ristrukturimit, të paraqesë propozimet për lirim nga shërbimi civil, të atyre nëpunësve pozicioni i të cilëve nuk ekziston më, apo është riorganizuar, kompetencë e tij që është e parashikuar në pikën 3 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në Vendimin nr.171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave.

c) Njësia përgjegjëse, pasi të analizojë propozimet e Komisionit të Ristrukturimit, të përmbyllë procesin e ristrukturimit me vendimin përfundimtar, për lirim nga shërbimi civil, për punonjësit të cilëve u shkurohet vendi i punës dhe nuk mund të sistemohen në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, apo riemërimin e punonjësve në pozicione të të njëjtës kategori, sipas dispozitave të mësipërme. Në këtë moment duhet të tregohet kujdes, që në rastet e uljes në detyrë të punonjësit, të merret mendimi i tij me shkrim për pranimin ose refuzimin e pozicionit të ofruar, siç përcaktohet në pikën 19 dhe 20, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”.

6. Njësia përgjegjëse të përfundojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet që janë pjesë e shërbimit civil, sipas parashikimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, që përbën një proces kompleks dhe që është kusht pa të cilin nuk mund të kryhet risistemimi i punonjësve në të njëjtin pozicion, transferimi i tyre apo rregjistrimi i tyre në listën e pritjes. Kjo për faktin se puna e Komisionit të Ristrukturimit është e lidhur ngushtë me krahasimin e kërkesave specifike për pozicionin e punës, ç’ka është një aspekt i rëndësishëm që formalizohet praktikisht në formularin e përshkrimit të punës.
7. Njësia përgjegjëse duhet të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit, nëpërmjet revokimit të aktit të emërimit, në rastet kur pozicionet e punës janë plotësuar në kundërshtim me ligjin, pasi nuk janë respektuar procedurat për pranimin në shërbimin civil, për punonjësit: ***** , emëruar si punonjëse e Këshillit të Qarkut Korçë, me Urdhërin nr. 65, datë 16.10.2014, të titullarit të institucionit; ***** , emëruar si punonjëse e Këshillit të Qarkut Korçë, me Urdhërin nr. 73, datë 07.11.2014 të titullarit të institucionit; ***** , emëruar pranë Këshillit të Qarkut Korçë me Urdhërin nr. 28, datë 24.09.2014, të titullarit të institucionit; ***** , emëruar pranë Këshillit të Qarkut Korçë, me Urdhërin nr. 45, datë 26.06.2014, të titullarit të institucionit; ***** , emëruar pranë Këshillit të Qarkut Korçë me Urdhërin nr. 58, datë 09.10.2014, të titullarit të institucionit.
8. Për të gjitha pozicionet e punës që do të mbeten të lira, sipas pikës 7 të këtij vendimi, njësia përgjegjëse të vijojë me procedurat e plotësimit të tyre duke ndjekur këtë rend:

Së pari, Komisioni i Ristrukturimit të bëjë krahasimin e kërkesave të punës për këto pozicione, nëse përputhen me kriteret që plotësojnë punonjësit që gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe që janë prekur nga procesi i ristrukturimit;

Së dyti, në rast se asnjë nga këta punonjës nuk i plotëson kriteret për t’u punësuar në këto pozicione, atëherë të shpallen si pozicione të lira dhe të vijojnë procedurat për plotësimin e tyre në përputhje me ligjin.

9. Të revokohen aktet administrative të pezullimit nga detyra dhe aktet administrative të lirimit nga shërbimi civil, të evidentuara nominalisht në raportin e inspektimit, kapitulli II/2/c, "Nëpunës civilë të pezulluar dhe më pas të liruar, pas procesit të ristrukturimit", për punonjësit: ***** , "Specialist", në Drejtorinë e Financës; ***** , "Specialist", në Drejtorinë e Financës; ***** , "Specialist", në Drejtorinë e Investim Shërbimeve; ***** , "Specialist", në Drejtorinë e Investim Shërbimeve; ***** , "Specialist", në Drejtorinë e Investim Shërbimeve; ***** , "Drejtor", në Drejtorinë e Urbanistikës; ***** , "specialist", në Drejtorinë e Urbanistikës; ***** , "Specialist", në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore; ***** , "Inspektor", në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës; ***** , "Inspektor", në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës; ***** , "Inspektor", në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës.

Të vijojnë procedurat për sistemimin e tyre pas ristrukturimit, sipas orientimeve që janë dhënë nga Komisioneri në raportin e inspektimit.

10. Të revokohen aktet administrative në lidhje me dhënien e masës disiplinore "largim nga shërbimi civil", në ngarkim të punonjësës ***** , Urdhëri nr.45, datë 30.06.2014, i titullarit të institucionit dhe punonjësit ***** , Urdhëri nr. 53, datë 06.10.2014, i titullarit të institucionit, sepse ndodhemi në kushtet e pavlefshmërisë absolute të aktit, në kuptim të neni 115 e vijim të Kodit të Procedurave Administrative, pasi këto akte kanë dalë në kundërshtim me procedurat ligjore që duhen respektuar gjatë një procedimi disiplinor, duke i mohuar në këtë mënyrë të drejtën punonjësve për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në këtë rast.
11. Njësia përgjegjëse të fillojë procesin e vlerësimit të punës për nëpunësit civilë dhe të kujdeset që ky proces të realizohet në të gjitha fazat e tij, deri në finalizimin me një vlerësim përfundimtar të argumentuar, sipas rekomandimeve në raport.
12. Njësia përgjegjëse të miratojë planin vjetor të pranimit në shërbimin civil, si detyrim që rrjedh nga zbatimi i nenit 18 i ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe Vendimit nr. 108, 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil".
12. Të plotësohet dosja e personelit në të gjitha rastet e konstatuara me mangësi në drejtim të administrimit të dokumentacionit si dokumentacioni që provon procesin e konkurimit, vërtetimi i gjëndjes gjyqësore dhe i gjëndjes shëndetësore. Pasi të hartohen dokumentat si përshkrimi i punës dhe vlerësimi i punës, ato duhet të bëhen pjesë e dosjes së personelit së bashku me të gjitha aktet e tjera që materializojnë ecurinë në detyrë të nëpunësit civil.
13. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat 30 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.

14. Me kalimin e këtij afati, subjekti i inspektuar, Këshilli i Qarkut Korçë duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
15. Për këtë vendim të njoftohet Këshilli i Qarkut Korçë, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të inspektimit dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni i Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA